

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
BASHKINË KORÇË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Bashkinë Korçë**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2014 deri më 01.09.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr.191, datë 31.12.2015.

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 768/8 datë 31.12.2015, i ka rekomanduar z. Sotiraq File, Kryetar i Bashkisë Korçë, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. PËRMIRËSIME LIGJORE

Gjetje. Me financim të Buxhetit të Shtetit, Bashkia Korçë, në datën 22.10.2014 ka zhvilluar procedurën e konkurrimit publik për objektin: “Restaurimi i pazarit të vjetër të Korçës”, me vlerë kontratë 260 milion lekë. Kjo procedurë konkurrimi, nuk është zhvilluar sipas Rregullave të Prokurimit Publik, por është zhvilluar në mbështetje të nenit 18 Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, dhe akteve nënligjore nxjerrë në zbatim të tij. Mirëpo në ligjin Nr 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i cili ka dalë rreth 3 vjet më vonë se Ligji nr. 9048, datë 07.04.2003, në të cilin punimet e restaurimeve, nuk janë përfshirë në rastet përjashtimore të parashikuara në nenet 5, 6, 7, 8 e 9 të tij. Nisur nga kjo, Ministria e Kulturës Rinise dhe Sporteve që në vitin 2007, para se të kërkonte në KM, miratimin e Vendimin Nr.216 datë 18.04.2007 “Për procedurat e konkurrimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të licencuara për restaurimin e monumenteve të kulturës”, para se të nxirrte Udhëzimin Nr. 446 datë 05.07.2007 “Për miratimin e dokumenteve standarde të konkurrimit publik për restaurimin e monumenteve të kulturës”, duhet të kërkonte ndryshimin e ligjit për prokurimin publik, duke përfshirë edhe punimet e restaurimit si rast përjashtimor nga rregullat e prokurimit publik, ose me hyrjen në fuqi të ligjit për prokurimin, përzgjedhja e subjekteve të licencuara për punimet e restaurimeve, duhet të bëhej në zbatim të Rregullave të Prokurimit Publik .

Rekomandim. Bashkia Korçë të marrë masa , të ngrejë grup pune dhe të përgatisë argumentet e nevojshme, duke i kërkuar Ministrisë së Kulturës, që të marrë nismën ligjore për përfshirjen e punëve restauruese në objekte të trashëgimisë kulturore, si rast përjashtimor, të përcaktuara në ligjin Nr 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”.

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje: Nuk janë zbatuar rekomandimet të gjitha rekomandimet e lëna, nga auditimi i kaluar dhe të ri kërkuara nga KLSH, me shkresën nr. 11253/74, datë 27.3.2015. Konkretisht: nga 6 masa organizative, me vlerë 1,860,000 lekë, mungesë të ardhurash nga 30 subjekte, janë zbatuar 2 masa, pa zbatuar janë 2 masa dhe janë në proces 2 masa. Nuk janë arkëtuar vlera monetare, për 11 masa shpërblim dëmi me vlerë 3,464,708 lekë, të ri rekomanduara, janë zbatuar 9 masa duke arkëtuar 541,160 lekë nga 3 subjekte, zbatuar pjesërisht 1 masë duke arkëtuar shumën 74,881 lekë nga 1 subjekt, pa zbatuar 1 masë për shumën 367,542 lekë. Në total janë arkëtuar 616,041 lekë, ngelen pa arkëtuar 2,848,667 lekë. Nga 1 masë administrative, të rikërkuar për arkëtimin nga mbikëqyrësit i punimeve “T.. G...” në vlerën 50,000 lekë .

Rekomandim: Bashkia Korçë të marrë masat e nevojshme administrative dhe ligjore, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së të rekomanduara me shkresën nr. 11253/74, datë 27.3.2015, për zbatimin e tyre të njoftohet me shkrim brenda afatit ligjor KLSH.

2. Gjetje: Nuk janë zbatuar kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” si:

- Nuk është caktuar koordinatori i riskut dhe nuk janë evidentuar risqet dhe masat për menaxhimin e tij.

- Nuk janë përcaktuar rregulla për administrimin dhe ruajtjen e aktiveve të qëndrueshme, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Nuk janë miratuar gjurmët për auditimin, në kundërshtim me nenin 16 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010.

- Nuk janë identifikuar zonat me risk dhe rrjedhimisht nuk është përpiluar strategjia për menaxhimin e tij, nuk është hapur regjistri i riskut, ku të regjistrohen raportimet dhe masat e marra për parandalimin e mashtrimit dhe parregullsive .

Rekomandim: Bashkia Korçë të marrë masa dhe të vlerësojë shkeljet e konstatuara të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe të punojë për implementimin e kërkesave ligjore.

3. Gjetje: Në auditimin e dokumentacionit për strukturën organizative dhe nivelin e pagave të punonjësve të Bashkisë Korçë, është konstatuar se nuk janë në përputhje me lidhjen 4 të VKM nr. 1619, datë 02.07.2008, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin njësive të qeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, të ndryshuar me VKM nr. 598 datë 27.04.2009, VKM nr. 553, datë 11.8.2011, VKM nr. 518 datë 16.08.2012 dhe VKM nr. 586, datë 17.7.2013, pasi në një rast pagesa është bërë sipas kategorisë II-b, me shtesë për pozicionin për 48,000 lekë/muaj. Ndërkohë që duhet të paguheshin sipas Vendimit të Këshillit të Bashkisë në kategorinë III-a/1, me shtesë për pozicionin duke marrë nivelin maksimal 45,100 lekë/muaj dhe në një rast pagesa është bërë sipas kategorisë I-b, me shtesë për pozicionin për 60,000 lekë/muaj, duhet të paguheshin sipas Vendimit të Këshillit të Bashkisë në kategorinë II-b, me shtesë për pozicionin duke marrë nivelin maksimal në vlerën 51,450 lekë në muaj .

Rekomandim: Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masa që në mbledhjen më të afërt të Këshillit Bashkiak, të përgatisë e paraqesë për miratim, ndryshimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të punonjësve të bashkisë, sipas dispozitave ligjore të mësipërme.

4. Gjetje: Për vitin 2015, Bashkia Korçë, ka lidhur në 4 raste kontrata për marrjen me qira të ambienteve publike private për qendra komunitare, për aktivitete social-kulturore për moshën e tretë e fëmijët, me afat qiramarrje 1 vjeçar. Lidhja e kontratave është bërë bazuar në certifikatat e pronësisë fotokopje, të pa noterizuara dhe pa prani të noterit, gjë e cila është në kundërshtim me kërkesat e pikës 5, VKM nr. 469, datë 3.6.2015 “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtimit për qëllime tatimore” .

Rekomandim: Bashkia Korçë të marrë masa dhe për kontratat e reja për qiramarrje, të lidhen në prani të noterit, duke zbatuar kërkesat ligjore në fuqi, duke shmangur parregullsitë e konstatuara e trajtuar më sipër.

5. Gjetje: Për vitet 2014-2015 Bashkia Korçë, ka prodhuar dhe shpërndarë falas për komunitetin revistën: “Bashkia e Korçës” me vlerë të kontratës 774,000 lekë. Shpërndarja e kësaj reviste, është bërë për njësitë administrative të bashkisë, si dhe për 4 librari private, pa akt-dorëzim dhe në mungesë të një akt marrëveshje apo kontrate të lidhur midis Bashkisë Korçë dhe subjekteve private. Kjo praktikë e shpërndarjes së revistave, është në kundërshtim me kërkesat e pikat 35/b dhe 38, Kap. III të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, dhe neni 659, 660, kreu I dhe neni 772, kreu IV ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar .

Rekomandim: Bashkia Korçë të marrë masat e nevojshme, të dokumentojë shpërndarjen falas të revistës: “Bashkia e Korçës” , sipas kërkesave të dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet juridike ndërmjet subjekteve shtetërore e private.

6. Gjetje: Në disa llogari të pasqyrave financiare, u konstatuan regjistrime kontabël të gabuara, me vlera materiale të konsiderueshme, të cilat sjellin si pasojë deformime të rezultatit financiar dhe të besueshmërisë mbi gjendjen e llogarive të pasqyrave financiare. Konkretisht, në debi të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” dhe në kredi të llogarisë 101 “Fonde bazë”, në një rast janë regjistruar detyrime të pa paguara në vite të biznesit të vogël, për taksat dhe tatimet lokale në shumën totale 55,173,915 lekë, dhe në një rast tjetër në vlerën 2,000,000 lekë janë regjistruar detyrimet e pa paguara nga Bashkia Korçë, që rrjedhin nga kontratat për blerje trualli për nevoja publike. Rritja e llogarisë 101 “Fonde bazë” dhe paraqitja në aktivin e bilancit, si gjendje debitorë për detyrimet e biznesit të pa paguara në vite, është në shkelje të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar dhe akteve nënligjore nxjerrë në zbatim të .

Rekomandim: Drejtoria e Financës të marrë mas dhe të bëjë rregullimet e nevojshme kontabël, në përputhje me kërkesat ligjore, me qëllim që llogaritë e pasqyrave financiare të pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen financiare të Bashkisë Korçë.

7. Gjetje: Gjatë vitit 2014, Bashkia Korçë ka qenë në vështirësi financiare dhe për pasojë në llogarinë 434 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)” dhe kredi të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, janë regjistruar detyrimet e pa paguara të situacionuara dhe të faturuara nga subjekti sipërmarrës për pastrimin e qytetit nga operatori ekonomik “Korseli shpk” në shumën 50,427,157 lekë. Kjo vlerë përfaqëson detyrimet vjetore të pa paguara ndaj subjektit “Korseli shpk”, sipas kontratës me afat 5 vjeçar të lidhur midis palëve. Gjatë viti 2014, bashkia ka paguar vetëm detyrimet e vitit 2013 ndaj këtij subjekti dhe nuk ka mundur të financojë detyrimet e lindura në vitin 2014 .

Rekomandim: Bashkia Korçë të marrë masa dhe të analizojë gjendjen ekonomike-financiare të saj, me qëllim që të përmirësojë aftësitë paguese dhe zvogëlimin gradual të detyrimeve kreditore, ndaj sipërmarrësve për punime e shërbime të kryera sipas kontratave të lidhura, mbetur pa likuiduar për mungesë aftësie paguese.

8. Gjetje: U konstatuan në 6 raste për vlerën 487,991 lekë, janë kryer shpenzime për personat e moshuar e të vetmuar. Por marrja në dorëzim e shërbimit, nuk është bërë nga komisioni i ngritur për këtë qëllim, kjo procedurë e kryerjes së shpenzimeve është në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar .

Rekomandim: Bashkia Korçë të marrë masa, të rishikojë procedurat e monitorimit dhe autorizimit të shpenzimeve operative për aktivitetet social kulturore, me qëllim

marrihen e tyre në dorëzim me komision, në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

9. Gjetje: Autoriteti Kontraktor Bashkia, Korçë në procedurën e konkurrimit për “RESTAURIMI I PAZARIT TË VJETËR KORÇË”, ka vepruar në kundërshtim me bazën ligjore që rregullon konkurrimin publik, për punimet e restaurimit të monumenteve të kulturës sepse: nga njëra anë ka s`kualifikuar nga procedura e konkurrimit subjektin “L.....”, me ofertën ekonomike në vlerën 219,197,473 lekë, i cili plotësonte kërkesat ligjore kualifikues dhe kriteret vlerësuese dhe nga ana tjetër ka kualifikuar dhe ka shpallur fitues subjekt tjetër “E....& “A.... ”, me ofertën ekonomike në vlerën 257,073,709 lekë, i cili nuk plotësonte kriteret vlerësuese. Nga ky veprim i është shkaktuar buxhetit të shtetit përdorim fondesh pa efektivitet në vlerën 37,876,236 lekë .

Rekomandim: Bashkia Korçë, në rastet e konkurrimit publik të punëve restauruese, kriteret e veçanta të hartohen dhe të vendosen në Dokumentet e Konkurrimit për fazën e shqyrtimit të kriterëve vlerësuese për përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike dhe jo në fazën e pranim kualifikimit.

10. Gjetje: Kontrata e shërbimit për mbikëqyrjen e punimeve për Restaurimin e pazarit të vjetër të Korçës, është realizuar nga Bashkia nëpërmjet procedurave të prokurimit në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për rregullat e prokurimit publik”. Kjo procedurë prokurimi është zhvilluar në kundërshtim me, ligjin Nr. 9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgimin Kulturore”, dhe me VKM nr 216 datë 18.04.2007 “Për procedurat e konkurrimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të licencuara për restaurimin e monumenteve të kulturës”. Pra, kjo procedurë prokurimi nuk duhej të zhvillohej nga Bashkia Korçë, por punimet e restaurimit duhet të mbikëqyreshin nga specialistë të Institutit të Monumenteve të Kulturës .

Rekomandim: Bashkia Korçë, në rastet kur do të lidh kontrata për punimet restauruese, duhet ti kërkojë Ministrisë së Kulturës dhe Institutit të Monumenteve të Kulturës angazhimin e specialisteve të tyre për mbikëqyrjen e punimeve restauruese.

11.Gjetje: Për të gjitha procedurat e prokurimit të realizuara, kërkesat e specifikimeve teknike janë hartuar në zbatim të Rregullave të Prokurimit Publik por, për disa zëra pune dhe materiale që do të përdoren në objekt nuk janë hartuar në përpjesëtim të drejtë me objektin dhe vlerën e kontratave. Kërkesat e specifikimeve teknike janë vendosur tip dhe janë standard, pothuajse për të gjitha kontratat për punë që ka lidhur dhe ka realizuar ky Autoritet Kontraktor gjatë vitit 2014 dhe 2015, pa marrë parasysh objektin, natyrën e kontratës dhe vlerën e saj .

Rekomandim: Për çdo rast të prokurimit të kontratave të punëve dhe shërbimeve “specifikimet teknike”, duhet të hartohen në përpjesëtim të drejtë me vlerën e kontratës dhe të lidhen ngushtë me objektin dhe natyrën e saj.

12. Gjetje: Në të gjitha procedurat e prokurimit, ato zëra punë të preventivave që përfshiheshin në manual teknik të miratuara me VKM, janë vendosur çmimet e këtij manuali, ndërsa për ato zëra që nuk janë përfshirë në këtë manual, çmimet janë vendosur duke u bazuar në analizat teknike të çmimeve. AK për llogaritjen e vlerës së kontratës, nuk duhej të mjaftohej vetëm me analizën e çmimeve, por duhej të ngrinte grup pune për studimin e çmimeve të tjera alternativave, duke ju referohej çmimeve të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik. Dhe mbas studimit të këtyre çmimeve të llogarisë vlerën e kontratës në bazë të çmimeve që ishin më me leverdi ekonomike.

Rekomandim: Për çdo procedurë prokurimi, në përllogaritjen e vlerave të kontratave të ngrihet grup pune për studimin e çmimeve alternativave të përcaktuara në rregullat

e prokurimit publik dhe të merren në konsideratë, çmimet që janë më me leverdi ekonomike.

13. Gjetje: Njësia e prokurimit ka hartuar dhe vendosur në DT të çdo procedure, kriteret e veçanta kualifikuese. Disa nga këto kriteret nuk janë përcaktuar në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, që do të prokurohet dhe janë diskriminuese, sepse janë hartuar të fryra dhe kufizuese, si dhe nuk stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm. Nga ky veprim, krijohet përshtypja sikur janë vendosur enkas për të favorizuar dhe përzgjedhur operatore të veçantë. Këto kanë sjellë si pasojë kthimin e procedurave të prokurimit të hapura kombëtare në procedura lokale, apo të drejtpërdrejta (me negociim). Veprime këto, në kundërshtim, me nenin 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”. Konkretisht, është kërkuar që operatorët ekonomik të kualifikohen, duhet të paraqesin:

- Certifikatat e cilësisë dhe teste laboratorike të disa materialeve të furnizuara që do të përdoren në objekte.

*Këto kërkesa të veçanta, janë kërkuar njëherë dhe janë shprehur qartë në DT në kapitullin e “specifikimeve teknike” të cilat respektohen dhe përmbushen nga operatori fitues gjatë zbatimit të punimeve. Për të vërtetuar dhe mbajtur këtë angazhim sipas DST, të gjithë operatorët që paraqesin ofertat në procedura prokurimit, duhet të vetdeklarojnë që gjatë zbatimit të punimeve do të përmbushin dhe respektojnë specifikimet teknike të vendosura në DT. Respektimi i tyre kontrollohet nga mbikëqyrësi i punimeve i cili kontraktohet nga investitori, pikërisht për kontrollin e zbatimit të punimeve në përputhje me projektin, preventivin e punimeve dhe me këto specifikime teknike. Ky arsyetim është shprehur qartë në rregullat e prokurimit publik të cilat nuk kërkojnë që në kriteret e veçanta kualifikuese, operatorët të paraqesin testet laboratorike të materialeve, që do të përdoren në objekt, por përcaktojnë se, mund tu kërkohet të paraqesin vetëm certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga sistemet e standardizimit kombëtar ose ndërkombëtar. **Për më tepër kjo kërkesë është penguese**, pasi të kërkojë bërjen e testeve brenda 23 ditësh nga data e publikimit të tenderit, është pothuajse e pamundur, që një ofertues të kontaktojë dhe të negociojë me një kompani të huaj për realizimin e një marrëveshjeje për çmimet dhe kryerjen e testeve të materialeve.*

- Për disponimin e Nyjës së thyerjes të materialeve inerte. Në rast se është në pronësi duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë, plan vendosjen e nyjës, pagesën e tre viteve të fundit të garancisë financiare të rehabilitimit të mjedisit, lejen minerare të shfrytëzimit si dhe lejen mjedisore. Në rast se Nyja e thyerjes është me qira duhet të paraqitet kontrata e qirasë e shoqëruar me dokumente që vërtetojnë pronësinë e nyjës, planin e vendosjes të nyjës, pagesën e tre viteve të fundit të garancisë financiare të rehabilitimit të mjedisit, lejen minerare të shfrytëzimit si dhe lejen mjedisore. Në rast se nuk ka në pronësi apo me qira duhet të paraqitet kontrata e furnizimit me prodhuesin ku të përcaktohet afati dhe objekti i prokurimit e shoqëruar me dokumente që vërtetojnë pronësinë e saj, planin e vendosjes të nyjës, pagesën e tre viteve të fundit të garancisë financiare të rehabilitimit të mjedisit, lejen minerare të shfrytëzimit si dhe lejen mjedisore.

Kërkesat e mësipërme janë tepër kufizuese, penguese dhe diskriminuese për operatorët ekonomik, pasi furnizimi me materiale inerte, nuk është i lidhur domosdoshmërisht me pronësinë e nyjës, plan vendosjen e saj dhe me lejen e shfrytëzimit të karrierës, lejen mjedisore, pagesën e tre viteve të fundit të garancisë

financiare të rehabilitimit të mjedisit, etj, kjo sepse inertet që do të përdoren në objekt janë materiale të cilat gjenden lehtësisht në treg pa qenë nevoja e disponimit të nyjës për thyerjen e tyre. Kjo kërkesë mundë të plotësohet dhe vërtetohet lehtësisht nga ofertuesit nëpërmjet kontratës së furnizimit apo të pronësisë së pikës së shitjes së inerteve, etj, pa qenë nevoja të kërkuar të gjithë këtë dokumentacion kufizues dhe të vështirë për të përgatitur një oferte teknike brenda 23 ditësh.

-Për disponimin e Fabrikës së asfaltobetonit dhe Fabrikën e betonit. Në rast se ato janë në pronësi duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë e tyre, plan vendosjen e tyre ku të tregohet distanca nga objekti që prokurohet e cila duhet të jetë jo më e madhe se 15 km .

Në rast se Fabrika e asfaltobetonit dhe Fabrika e betonit është me qira duhet të paraqitet kontrata e qirasë e shoqëruar me dokumente që vërtetojnë pronësinë e tyre plan vendosjen e tyre ku të tregohet distanca nga objekti që prokurohet e cila duhet të jetë jo më e madhe se 15 km.

Në rast se ato nuk janë në pronësi apo me qira, duhet të paraqitet kontratë furnizimi me prodhuesin ku të përcaktohet afati dhe objekti i prokurimit e shoqëruar me dokumente që vërtetojnë pronësinë e tyre, plan vendosjen e tyre ku të tregohet distanca nga objekti që prokurohet e cila duhet të jetë jo më e madhe se 15 km. Në rast se këto **fabrika janë të lëvizshme**, duhet të paraqesë kontratën e qirasë me pronarin e tokës ku do të montohet fabrika, skemën teknologjike që vërteton që është e lëvizshme, lejen ndërtimore provizore dhe lejen mjedisore.

Vendndodhja e fabrikave të asfaltit dhe të betonit të cilat duhet të jetë në distance jo më e madhe se 15 km nga objekti i prokurimit, është një pengesë e madhe dhe një kufizim dhe diskriminim për operatorët ekonomik, që kryejnë aktivitet mbi 15 km nga qyteti i Korçës. Po kështu përveç distancës është vendosur edhe pengesa dhe kufizimi tjetër i disponimit të fabrikës së asfaltit dhe betonit të lëvizshme, për të cilën operatorët duhet të paraqesin një sërë dokumente dhe lejen ndërtimore provizore dhe lejen mjedisore. Në këtë rast kemi të bëjmë me pamundësi reale për plotësimin e kësaj kërkesë nga ofertuesit sepse, vetëm marrja e lejes ndërtimore provizore dhe lejes mjedisore kërkon afate të cilat tejkalojnë 23 ditë që është afati i përgatitjes së ofertave, kur dihet që vetë njësitë vendore afatin e shqyrtimit dhe dhënien e lejeve ndërtimore e kanë 45 ditë nga paraqitja e kërkesës.

13.1. Rekomandim:

a. Bashkia Korçë në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, për çdo procedurë prokurimi që do të kryhej, për kontratat e punëve në kriteret e veçanta, të shmang vendosjen e kërkesave diskriminuese, duke u kërkuar ofertuesve, që për të vërtetuar se punët i plotësojnë sipas kërkesave të cilësisë në përputhje me specifikimet teknike, duhet të paraqesin vetëm certifikatat e cilësisë të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga sistemet e standardizimit kombëtar ose ndërkombëtar, siç kërkohej shprehimisht nga rregullat e Prokurimit Publik.

b. Kriteret e veçanta të hartohen, duke mos vendosur kufizime dhe pengime të pa arsyeshme, me qëllim stimulimin e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të çdo operatori ekonomik që kryhen veprimtari ndërtuese, në të gjithë territorin e vendit.

14.Gjetje: Parregullsitë dhe shkeljet e mësipërme, janë bërë “shkaqe ose pretekste subjektive” për s’kualifikime të padrejta të operatorëve pjesëmarrës duke i shkaktuar buxhetit të Bashkisë përdorim të foneve pa efektivitet në vlerën totale **58,946,000 lekë**, për arsyen se këto kërkesat siç u tha mësipërm, janë tejet të vështira apo të pamundura për tu përmbushur nga operatorët ekonomik të interesuar për procedurën e

prokurimit. Në ankesat e paraqitura nga operatorët pjesëmarrëse në këto prokurime, kanë kërkuar modifikimin dhe korrigjimin e këtyre kërkesave. AK, ka vepruar ndryshe, në kundërshtim me, nenin 42 dhe 63 të ligjit nr. 9642, datë 20.11.2006, në asnjë rast nuk i ka shqyrtuar këto kërkesa, dhe i ka kthyer përgjigje operatorëve që, ankesat Tuaja nuk merret parasysh sepse, janë jashtë afateve të ankimimit, dhe natyrshëm të gjithë këta operatorë nuk kanë marrë pjesë në procedurat e prokurimit. Konkretisht, përdorimi pa efektivitet i fondeve është konstatuar në këto procedura:

-“Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare “Mësonjëtorja e parë”, me fond limit 48,430,009 lekë, me operator fitues “Xh...” me vlere oferte 44,703,729 lekë, është konstatuar përdorim pa efektivitet i fondeve, në vlerën 4,568,628 lekë.

-“Rikonstruksion i shkollëve dhe varrezave të dëshmoreve”, me fond limit 19,410,096 lekë, me operator fitues “Xh...” me vlere oferte 18,588,990 lekë është konstatuar përdorim pa efektivitet i fondeve në vlerën 1,914,480 lekë.

-“Rikonstruksion i rrugës Gjon Buzuku” me fond limit 241,990,774 lekë, me operator fitues “Xh...” me vlere oferte 235,505,378 lekë është konstatuar përdorim pa efektivitet i fondeve në vlerën 42,647,063 lekë.

-“Përmirësimi i infrastrukturës rrugore ne qytet”, me fond limit 41,642,0154 lekë, me operator fitues “Xh.....” me vlere oferte 39,955,188 lekë është konstatuar përdorim pa efektivitet i fondeve në vlerën 964,727 lekë.

-“Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Stavri Themeli”, me fond limit 41,666,221 lekë, me operator fitues “K.....” me vlerë oferte 35,928,064 lekë është konstatuar përdorim pa efektivitet i fondeve në vlerën 8,851,194 lekë .

Rekomandim: Në çdo procedurë prokurimi, ankesat apo kërkesat e operatorëve ekonomik për modifikimin dhe korrigjimin e dokumenteve të tenderit, të merren në shqyrtim nga AK në zbatim të nenit 42 të ligjit nr. 9642, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, duke kthyer përgjigje me argumente bindëse ligjore si pranuese dhe refuzuese.

15.Gjetje: Po kështu, kërkesat e veçanta, janë bërë arsye për mos nxitje të pjesëmarrjes e operatorëve ekonomikë, shmangej të konkurrencës, mospagim dhe mostrajtim të barabartë dhe jo diskriminues ndërmjet operatorëve ekonomikë, duke bërë që pjesa më e madhe e financimeve buxhetore dhe financimeve nga të ardhurat e vetë Bashkisë të destinuara për investime në punët publike në qytetin e Korçës të dominohen dhe të përqendrohen vetëm në dy operatorë ekonomik, në kundërshtim me ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me ligjit nr. 9643, datë 20.11.2007 “Për prokurimin publik”. Konkretisht, gjatë periudhës qershor-tetor 2014, operatori ekonomik “E..” ka marrë 3 kontrata me vlerë të përgjithshme rreth *801 milion lekë*, nga rreth 1 miliard lekë investime të akorduara në këtë vit, ose ka marrë rreth 80 % të investimeve dhe pjesën tjetër e ka marrë operatori ekonomik “Xh....” me 4 kontrata me vlerë të përgjithshme rreth 121 milion lekë. Po kështu operatori ekonomik “Xh....” gjatë 8 muorit të vitit 2015, ka marrë edhe 4 kontrata të tjera me vlerë të përgjithshme rreth 482 milion lekë, nga rreth *602 milion lekë* investime të akorduara gjatë kësaj periudhe, ose 80 % të tyre. Pra, të dy këta operatorë kanë marrë pothuajse 80-92 % të investimeve totale të dy viteve. Dhe gjatë kohës së realizimit të çdo procedure vijuese kanë pasur më parë kontrata të tjera të lidhura me Bashkinë Korçë për zbatim punimesh në objekte të ndryshme, të cilat i kanë pasur të pa përfunduara. Konkretisht: operatori “E...”, ka dalë fitues në tenderin për “Rikonstruksioni i parkut Rinia” i cili është zhvilluar në datën 09.07.2014, në një kohë që para një muaji kishte dalë fitues edhe në tenderin “Sheshi dhe rrugicat tek

kulla Panorama,sheshi tek teatri” të zhvilluar në datën 11.06.2014 dhe zbatimi i punimeve ishte me afat 6 mujor. Po kështu ka dalë fitues edhe më pas tre muajsh në tenderin për “Restaurimi i pazarit të vjetër të Korçës” të zhvilluar në datën 22.10.2014, në një kohë që i kishte të dy kontratat e pa përfunduara, madje edhe sot nuk janë përfunduar. Operatori ekonomik “Xh.....” ka dalë fitues në tenderin “Rik. i shkalleve dhe varrezave të dëshmorëve” i cili është zhvilluar në datën 17.10.2014, në një kohë që kishte dalë fitues edhe në tenderin “Terrene sportive në 4 shkolla të qytetit ” të zhvilluar një muaj më parë në datën 9.09.2014 dhe zbatimi i punimeve ishte me afat 3 mujor. Dhe, kështu me radhë, ka dalë fitues edhe në 6 procedura të tjera, në një kohë që i kishte kontratat e pa përfunduara, madje edhe sot disa prej tyre nuk kanë përfunduar ende. Për këto kontratat këta operatorë kanë deklaruar në çdo procedurë prokurimi se, disponojnë kapacitetet teknike dhe profesionale dhe i vënë në dispozicion të këtyre kontratave. Por, këta operatorë kanë hedhur në sistemin elektronik për të gjitha procedurat e prokurimit pothuajse të njëjta kapacitetet teknike e profesionale si dhe kanë deklaruar për të gjitha procedurat se i vënë këto kapacitete në dispozicion të çdo kontrate. *Nisur nga ky fakt*, AK nuk duhet ti kualifikonte dhe ti shpallte fitues këta operatorë në procedurat vijuese pa përfunduar më parë punimet sipas afateve të përcaktuara në kontratën e lidhur më parë, sepse me të njëjtat kapacitetet teknike e profesionale të angazhuara njëherësh në 2,3 ,4 apo 5 kontrata, është e pamundur të realizohen punimet brenda grafikut dhe afateve të kontratave. Ky veprim, ka ndikuar direkt edhe në vonesa të përfundimit të punimeve, pasi për shumicën e këtyre kontratave është kërkuar shtesë afati. Ky veprim gjithashtu, lejon hapësira që operatorët ndodhur para pamundësisë së përfundimit në kohë të punimeve, mund të shesin kontratat duke ja ngarkuar zbatimin e punimeve sipërmarrësve të tjerë, në dem të cilësisë së punimeve.

Rekomandim: Bashkia Korçë, në çdo procedurë prokurimi të kontratave për punë, të kërkojë miratimin e Agjencisë së Prokurimit Publik, që në dokumentet e tenderit, në kërkesat e veçanta të vendoset që, operatorët ekonomik që kanë kontrata të lidhura me Bashkinë Korçë dhe në rastet se, marrin pjesë në tenderë të tjerë, të s`kualifikohen nga procedura e prokurimit, nëse nuk kanë zbatuar 70% të kontratës së lidhur më parë.

16. Gjetje. Kontratat e shërbimit për mbikëqyrjen e punimeve për objektet: “Restaurimin e pazarit të vjetër të Korçës” me vlerë 216,767,033 lekë, “Rikonstruksioni i parkut Rinia” me vlerë 253,751,839 lekë dhe “Sheshi dhe Rrugicat tek kulla Panorama, Sheshi tek Teatri” me vlerë 201,595,522 lekë të realizuar në viti 2014, nëpërmjet procedurave të prokurimit janë fituar nga i njëjti operator ekonomik, “CEC-11”. Ofertat e këtij operatori janë shumë të ultë kundrejt fondit limit, konkretisht, fondi limit i mbikëqyrjes për “Restaurimin e pazarit të vjetër të Korçës” është 2,679,093 lekë ndërsa kontrata është fituar 396,000 lekë ose rreth 15 % e tij, fondi limit i mbikëqyrjes për “Rikonstruksioni i parkut Rinia” është në vlerën 2,833,000 lekë ndërsa kontrata është fituar në vlerën 656,000 lekë ose rreth 23 % e tij, dhe fondi limit i mbikëqyrjes për “Sheshin dhe Rrugicat tek kulla Panorama, Sheshi tek Teatri” është në vlerën 2,300,000 lekë, ndërsa kontrata është fituar në vlerën 756,000 lekë ose rreth 32 % e tij. Afatet e kontratave të mbikëqyrjes janë të njëjta me afatet e kontratave të zbatimit. Pra, kosto e shërbimit të mbikëqyrjes të 3 kontratave të këtij mbikëqyrësi janë shumë të ultë, çka tregon që ky operator ka vënë në dispozicion dhe ka angazhuar në të tre këto objekte stafin profesional pothuajse me kosto të papërfillshme.

Rekomandim: Bashkia Korçë, në çdo rast të procedurave të prokurimit të kontratave për shërbimin e mbikëqyrjes dhe shërbimin e kolaudimit të punimeve të ndërtimit, të kërkojë interpretimin dhe miratimin e Agjencisë së Prokurimit Publik, që vlerësimi i ofertës të mos bëhet për çmimin më të ulët, por të bëhet në bazë të “Kriterit të ofertës ekonomikisht më të favorshme” i përcaktuar qartësisht, në pikën 2, të nenit 31, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

17. Gjetje: Në kontratat me objekt “Rikonstruksioni i parkut Rinia” dhe “Zbatimi i Punimeve Sheshi dhe Rrugicat tek kulla Panorama, Sheshi tek Teatri”, janë kryer negociata çmimesh për zëra të rinj jashtë kontrate. Gjatë këtyre negociatave rezulton se janë miratuar zëra të rinj punimesh me efekte negative për buxhetin e Bashkisë në vlerën 1,700,946 lekë, si pasojë e pranimit të çmimeve të ofruara në mospërputhje me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, vendim ky i cili ka hyrë në fuqi më datë 21.07.2015, si dhe në mospërputhje me analizat teknike të kryera nga vetë specialistët e Bashkisë.

Rekomandim: Nga Bashkia Korçë, të marri masa për anulimin e çmimeve të para dhe ri negociimin e çmimeve të rinj në përputhje me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 si dhe udhëzimet përkatëse. Gjatë analizave të merren në konsideratë edhe ato të kryera nga ana e specialistëve të Bashkisë.

18. Gjetje: Për, kontratat të lidhura në datën 22.07.2014 për zbatimin e punimeve “Rikonstruksionin e parkut Rinia” dhe datë 01.07.2014 për zbatimin e punimeve “Sheshin dhe Rrugicat tek kulla Panorama, Sheshi tek Teatri” me subjektin “Eurokol” rezulton se, në situacionet nr. 8 dhe nr. 9 **janë deklaruar në mënyrë fiktive nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve, punime të pakryera dhe të likuiduara në vlerën 24,710,922 lekë.** Këto punime, ende rezultojnë të pakryera, deri në periudhën e ushtrimit të këtij auditimi. Këto veprime bien kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, dhe me aktet nënligjore në zbatim të tij .

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë, Korçë, të marri masa dhe të nxjerrë e përgjegjësinë, për raportimin fiktiv të punimeve të pakryera në situacionet nr. 8 dhe nr. 9, në vlerën **24,710,922 lekë** dhe të likuiduar paradhënie për sipërmarrësin e punimeve .

19. Gjetje: Dosjet teknike të investimeve, në disa raste rezultuan të pa plotësuara dhe me mangësi në dokumentacion, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

Rekomandim: Bashkia Korçë, të marri masa për plotësimin e dokumentacionit të dosjeve teknike të investimeve gjatë procesit të zbatimit të kontratave deri në dorëzimin e objektit.

20. Gjetje: Nga auditimi i të dhënave të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, rezulton se me datë 31.08.2015, vlera e detyrimeve debitorë ndaj Bashkisë Korçë paraqitet në vlerën 31,314,349 lekë, nga e cila; debitorët për familjarët për vlerën 6,065,177 lekë, për taksë toke , tarifë ndriçimi tarifë pastrimi dhe tarifë gjelbërimi dhe 25,249,172 lekë debitorët e biznesit të vogël për 474 subjekte në vlerën 8,734,178 lekë dhe 115 subjekte të biznesit të madh në vlerën 16,514,994 lekë.

Rekomandimi:Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masa për arkëtimin nga 594 subjekte debitorë të mbetur me datë 31.08.2015 në vlerën 25,249,172 lekë, nga e cila; biznesi i vogël për 474 subjekte me vlerë

8,734,178 lekë dhe biznesi i madh për 115 subjekte me vlerë 16,514,994 lekë dhe vlerën e debitorëve për familjarët në vlerën 6,065,177 lekë.

21. Gjetje: Në 5 leje zhvillimi/ndërtimi është shkelur afati 45 ditor për miratimin e saj, në kundërshtim aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë fushën e planifikimit dhe Zhvillimin e Territorit, të cilat përcaktojnë se, “Kryetari i bashkisë ose komunës, bazuar në opinionin teknik me shkrim të këshillit, vendos brenda 5 (pesë) ditëve, por jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës për zhvillim, miratimin e lejes, miratimin me ndryshime ose refuzimin e saj”.

Rekomandim: Të gjitha kërkesat e aplikantëve për leje zhvillimi /ndërtimi për kryerje punimesh, të shqyrtohen brenda afatit të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë fushën e planifikimit dhe Zhvillimin e Territorit.

22. Gjetje: Vendimet për Lejet e Zhvillimit nuk janë botuar në Regjistrin e Planifikimit, në kundërshtim me nenin 14, pika 7, të VKM Nr. 502, Datë 13.07.2011, të ndryshuar, në të cilët përcaktohet se, “Akti administrativ i kryetarit të komunës/bashkisë botohet në regjistër, në përputhje me nenin 53 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar” .

Rekomandim: Të gjitha vendimet për Lejet e Zhvillimit të botohen në Regjistrin e Planifikimit në përputhje me aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë fushën e planifikimit dhe Zhvillimin e Territorit.

23. Gjetje: Janë dhënë 5 leje ndërtimi, të cilat sipas Instrumentit të Përgjithshëm Vendor janë në kategorisë M3 të përdorimit të tokës që, i përket kategorisë “Ansambël Urbanistik”. Këto leje zhvillimi janë dhënë pa marrë miratimin e Institutit të Monumenteve të Kulturës, në kundërshtim me Rregulloren e Urbanistikës së Bashkisë Korçë, miratuar me vendim të KKT Nr. 13, datë 07.03.2014. Po kështu është konstatuar mungesë në dokumentacionin përbërës të këtyre dosjeve, në kundërshtim me ligjin Nr. 10119 datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”. Konkretisht, në dosje mungon pëlqimi mjedisor i cili lëshohet nga ARM Qarku Korçë, në zbatim të ligjit nr. 8934, datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit” .

Rekomandim: Në të gjitha rastet e kërkesave për leje Zhvillimore në kategorinë e tokës M3 “Ansambël Urbanistik” të mos shqyrtohen, para se të merret miratimi nga Instituti i Monumenteve të Kulturës.

Rekomandim: Të gjitha dosjet të plotësohet me dokumentacionin e përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë fushën e planifikimit dhe Zhvillimin e Territorit.

24. Gjetje: Në asnjë rast nuk është bërë shpallja publike e kërkesës për leje zhvillimore, sipas akteve ligjore e nënligjore, që rregullojnë fushën e planifikimit dhe Zhvillimin e Territorit.

Rekomandim: Në çdo rast të bëhet shpallja publike e kërkesës për leje zhvillimore sipas rregullave të caktuara.

25. Gjetje: Nuk ka asnjë akt të mbajtur për mbikëqyrjen e punimeve për dhënien e lejeve të përdorimit në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë fushën e planifikimit dhe Zhvillimin e Territorit .

Rekomandim: Në të gjitha rastet e lejeve të përdorimit të pajisen me aktin e mbikëqyrjes së punimeve në përputhje me kërkesat, që rregullojnë fushën e planifikimit dhe Zhvillimin e Territorit dhe fushën e disiplinimit të punëve të ndërtimit.

26. Gjetje: Në 15 raste tarifa e qirasë nuk janë paguar për çdo muaj, por janë paguar në 6 muaj, në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” .

Rekomandim: Bashkia Korçë të marrë masa të rishqyrtoj afatet e pagesës së qirasë, duke e përshtatur në pajtueshmëri me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

27. Gjetje: U konstatua se Kryeinspektorit të IMTV-së(ish INUV) për një periudhë 2 vjeçare, nuk është emëruar sipas kërkesave të ligjit nr. 152, datë 30.5.2013 “Për nëpunësin civil”, por është mbajtur i komanduar për këtë periudhë, pa kryer procedurat ligjore të punësimit, duke shmangur konkurimin e resurseve njerëzore .

Rekomandim: Kryetari Bashkisë Korçë të marrë masa, për plotësimin e strukturës së IMTV-së dhe të emëroj Kryeinspektorin në pajtueshmëri me procedurën e punësimit në shërbimin civil.

28. Gjetje: Policia Bashkiake nuk ka hartuar paketën me llojet dhe masat e gjobave për çdo shkelje, të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative, në kundërshtim me ligjin nr. 10.279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” .

Rekomandim: Policia Bashkiake në bashkëpunim me Drejtorinë e Tatim Taksave Vendore të marrë masa, për të hartuar paketën me llojet dhe masat e gjobave për çdo shkelje, të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative.

29. Gjetje: Rrugët vendore, pasuri të Bashkisë Korçë, me numër inventari 923, i janë dhënë në përdorim një agjenti tatimor privat për parkim. Këto asete nuk janë regjistruar në ZVRPP Korçë në kundërshtim me VKM nr. 1532, datë 19.11.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Korçë, Qarku i Korçës” dhe VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” .

29.1. Rekomandim: Bashkia Korçë të marrë masa për regjistrimin në ZVRPP Korçë të rrugëve vendore të cilat ndodhen në inventarin e Bashkisë me numër rendor 923 dhe që përdoren nga agjenti tatimor privat, për përdorim parkingu.

30. Gjetje: Bashkia Korçë me kontratën datë 27.06.2014 të lidhur me agjentin tatimor “A.... Security”, ka dhënë në administrimi për një periudhë 5 vjeçare, për vjeljen e tarifës së parkimit në rrugët e Qytetit. Procedura e ndjekur nga Bashkia Korçë për kontraktimin e subjektit, është bazuar në Udhëzimin nr. 7, datë 10.06.2008 “Mbi rregullat, kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për përzgjedhjen e subjektit që do të kryejë administrimin e shërbimit të parkimit/ve me pagesë në rrugë”. Kjo procedurë është në kundërshtim me procedurat e ligjit nr. 125/2013 datë 25.04.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” dhe më tej dhe me VKM nr. 575, datë 10.07.2013 “Për miratimin e rregullave për dhënien me koncesion / partneritet publik privat”. Këto akte normojnë pikërisht këtë marrëdhënie partneriteti dhe përcaktojnë një procedurë krejtësisht të ndryshme, në drejtim të kriterëve, kapaciteteve dhe mbi të gjitha në drejtim të procesit të konkurrimit. Akte ligjore të sipërcituara kanë sanksionuar gjithashtu se, procedurat realizohen në bazë të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, proces i cili nuk rezulton të jetë ezauruar. Njëherazi në Këshillin Bashkiak, nuk janë paraqitur alternativa bashkëpunimi me subjektet private, duke e bërë fakt mënyrën e

përzgjedhur nga strukturat e bashkisë. Subjekti i përzgjedhur si “Agjent Tatimor” për mbledhjen e tarifës së parkimit, nuk i ka përmbushur kërkesat për kualifikim të përcaktuara me VKB nr. 10, datë 05.02.2014 “Mbi zonat, tarifën, formën, kushtet financiare të bashkëpunimit dhe kriteret për përzgjedhjen e subjektit që do të kryejë administrimin e parkimit me pagesë në rrugë”, pasi për të përmbushur kriterin e kërkuar në pikën 12/b.1, asete në pronësi ose me qira, ka paraqitur kontratë qiraje me nr. 659 rep, 621 kol., datë 15.03.2014, në të cilën ka firmosur vetëm njëri prej bashkëpronarëve të pasurisë në kundërshtim me nenet 199-208 të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, duke e bërë kontratën nul dhe pa efekte juridike, çka sjell automatikisht edhe pasojën e pavlefshmërisë së aktit të paraqitur nga shoqëria pjesëmarrëse në konkurrim për të përmbushur kriterin e aseteve tërë, duke bërë që kjo e fundit mos të plotësojë një nga kriteret e vendosura nga Bashkia.

Rekomandim: Bashkia Korçë të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat ligjore për rivlerësimin dhe rishikimin e kontratës së lidhur me agjentin tatimor për vjeljen e tarifës së parkimit.

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

1.Gjetje: Për periudhën objekt i këtij auditimi, konstatohet se janë paguar nëpunës të Bashkisë si; Kryeinspektor i Inspektoratit Ndërtimor, në kategorinë II-b, me shtesë për pozicionin, për 48,000 lekë/muaj, kur në fakt duhet të paguhej sipas Vendimit të Këshillit të Bashkisë në kategorinë III-a/1, me shtesë për pozicionin duke marrë nivelin maksimal 45,100 lekë/muaj dhe Drejtor i Përgjithshëm sipas kategorisë I-b, me shtesë për pozicionin për 60,000 lekë/muaj, kur në fakt duhet të paguhej sipas Vendimit të Këshillit të Bashkisë në kategorinë II-b, me shtesë për pozicionin duke marrë nivelin maksimal 51,450 lekë në muaj, pra paguar më tepër për shumën 150,169 lekë, nga e cila; në vitin 2014 në shumën 89,376 lekë dhe në vitin 2015 në shumën 60,793 lekë, veprime në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në lidhjen 4, të VKM nr. 1619, datë 02.07.2008 “Për klasifikimin e funksioneve e grupimin e njësive të qeverisjes vendore dhe caktimin e kufijve të pagave të organeve të qeverisjes vendore”, i ndryshuar VKM nr. 598 datë 27.04.2009, VKM nr. 553, datë 11.8.2011, VKM nr. 518 datë 16.08.2012 dhe VKM nr. 586, datë 17.7.2013.

Rekomandimi: Të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar **shpërblimin e dëmit në vlerën totale 150,169 lekë**. Konkretisht, z. I.L i komanduar me detyrën e Kryeinspektorit të Inspektoriatit Ndërtimor, për vlerën 26,453 lekë dhe z. K.K, me detyrë Drejtor i Departamentit i të Ardhurave Vendore, për vlerën 123,716 lekë.

2. Gjetje: Nga struktura e IMTV-së të, janë marrë 13 vendime pezullimi për raste të konstatuara ndërtime në papajtueshmëri me legjislacionin në fuqi për të cilat nuk është marrë asnjë masë dënimi me gjobë, duke krijuar të ardhura të munguara në shumën 1,300,000 lekë, në kundërshtim me pikën 8 të nenit 82 ligjit nr. 10119 datë 23.04.2009 për “Planifikimin e Territorit” dhe germës b të nenit 5 të ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektoratin e ndërtimit”.

Rekomandim: Bashkia Korçë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e dëmit **në vlerën 1,300,000 lekë**, vlerë që përbëhet nga gjobat e pavendosura nga IMTV.

3.Gjetje: Nga struktura e IMT-së janë marrë 25 vendime për prishje të ndërtimeve në kundërshtim me ligjin nr. 10119 datë 23.04.2009 për “Planifikimin e Territorit”, për

të cilat nuk është marrë asnjë masë dënimi me gjobë, duke krijuar të ardhura të munguara në shumën 2,900,000 lekë, në kundërshtim me pikën 8 të VKM-së nr. 862, datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga INUK dhe INUV” i ndryshuar.

3.1. Rekomandim: Bashkia Korçë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e dëmit **në vlerën 2,500,000 lekë.**

C.1. MASA PËR PËRDORIMIN ME EFEKTIVITETE TË FONDEVE

1. Gjetje: Janë konstatuar 4 raste, të moszbatimit të afateve të kontratave nga sipërmarrësit e punimeve ndërtimore, objektet e të cilave ende nuk kanë përfunduar. Shtyrja e afateve është bërë bazuar në kërkesën e subjektit sipërmarrës dhe të supervisorit të saj të argumentuara nga temperaturat e ulëta për kryerjen e punimeve, si dhe raste të zënies së sheshit të punimeve. Në të gjitha rastet, Kryetari i Bashkisë Korçë ka miratuar shtyrjen pa afat të punimeve. Në të gjitha rastet, nuk është lidhur kontratë shtesë me subjekte sipërmarrëse dhe nuk janë evidentuar me procesverbal, nga supervisorit ditë vonesat dhe shkaqet e vonesave. Ndaj subjekteve sipërmarrëse, nuk është llogaritur dhe kërkuar penalteti i caktuar në kontratat dypalëshe dhe ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 850, 861 dhe UKM nr. 3, datë 15.2.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu I, pikat 4/d, 13 dhe 14. Në këto raste, vlera totale e penaltetit të pa llogaritur e shmangur në mënyrë të kundër ligjshme dhe të pa argumentuar me dokumentet e nevojshme nga Bashkia Korçë, është në vlerën 76,870,080 lekë, sipas subjekteve:

- **Vlera 29,259,600 lekë**, ndaj subjektit “E...” për objektin: “Sheshi dhe rrugicat tek kulla Panorama, sheshi tek teatri”. Kontrata e lidhur datë 1.7.2014 me afat 5 muaj.

- **Vlera 7,208,640 lekë**, ndaj subjektit “Meni” për objektin: “Qendra për mbrojtjen dhe promovimin e kulturës”. Kontrata e lidhur datë 16.10.2014 me afat 6 muaj.

- **Vlera 5,444,640 lekë**, ndaj subjektit “Xh...” për objektin: “Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në qytet”. Kontrata e lidhur datë 18.05.2015 me afat 2 muaj.

- **Vlera 34,957,200 lekë**, ndaj subjektit “E...” për objektin: “Rikonstruksion i Parkut Rinia”. Kontrata e lidhur datë 22.7.2014 me afat 5 muaj.

Rekomandimi: Bashkia Korçë të marrë masa dhe të analizojë shkaqet e mos zbatimit të punimeve brenda afateve të përcaktuar në kontratat e mësipërme. Të vlerësojë marrëdhënien juridike me këto subjekte, duke nxjerrë përgjegjësitë ligjore dhe financiare, për mos përfundimin e punimeve sipas grafikut dhe afateve të përcaktuara në këto kontrata sipërmarrjeje. Nëse kontratat shtesë për shtyrjen e afateve të përfundimit të punimeve nuk argumentohen ligjërisht, të kërkohet në rrugë administrative dhe ligjore, arkëtimi i penalteteteve për ditë vonesat nga subjektet e më sipërme, të llogaritura **në vlerën 76,870,080 lekë.**

2. Gjetje: Në datë 04.04.2011 është lidhur kontratë ndërmjet Bashkisë Korçë dhe subjektit “O..... K..”, me objekt “Shërbimi i transportit në qytetin e Korçës, me subvencionim”. Afati i kontratës është 5 vjet. Masa e subvencionimit nga bashkia Korçë për transportin e personave të moshës së tretë dhe për studentët është parashikuar 3,500,000 lekë në vit, pa amendamente për rishikimin e saj çdo vit. U konstatua se, për çdo vit, janë lidhur shtesë kontrate duke ndryshuar në rritje masën e subvencionit, duke sjell kështu, rritje fiktive të fondeve të Bashkisë Korçë në vlerën 8,482,570 lekë. Rritja e masës së subvencionit, është në shkelje të kërkesave të

kontratës të lidhur midis palëve dhe ligjit nr. 7850 , datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, pasi: në kontratën e lidhur midis palëve me afat 5 vjet, nuk është parashikuar ndryshimi i masës së subvencionit, nuk është parashikuar numri i personave përfitues të shërbimit urban falas dhe në kontratë, nuk është parashikuar mënyra e evidentimit të personave përfitues të shërbimit urban falas dhe lloji i dokumentit me të cilën ata duhet të identifikohen .

Rekomandimi: Bashkia Korçë, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve publike **në vlerë 8,482,570 lekë**, si dhe të ngrihet grup pune me specialistë të fushës për të rishikuar nivelin e subvencionit dhe mënyrën e dokumentimit të kërkesës për subvencion nga operatori privat.

3. Gjetje: Autoriteti Kontraktor Bashkia, Korçë në procedurën e konkurrit për “Restaurimi i pazarit të vjetër të Korçës, me vlerë kontrate të përllogaritur, rreth 260 milion ka vepruar në kundërshtim me bazën ligjore që rregullon konkurrimin publik për punimet e restaurimit të monumenteve të kulturës sepse: nga njëra anë ka s`kualifikuar nga procedura e konkurrit subjektin “L...”, me ofertën ekonomike në vlerën 219,197,473 lekë, i cili plotësonte kërkesat ligjore kualifikues dhe kriteret vlerësuese dhe nga ana tjetër ka kualifikuar dhe ka shpallur fitues subjekt tjetër “E.....&A....”, me ofertën ekonomike në vlerën 257,073,709 lekë, i cili nuk plotësonte asnjë kriter vlerësues. Kjo shkelje ka sjell për buxhetin e Bashkisë Korçë, impakt negativ me rritje fiktive të fondeve në vlerën 37,876, 236 lekë .

Rekomandim: Bashkia Korçë të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve publike **në vlerën 37,876, 236 lekë**.

4.Gjetje: Autoriteti kontraktor, në 5 (pesë) procedura prokurimi ka vepruar në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, sepse disa kriterë të veçanta kualifikuese nuk janë hartuar dhe përcaktuar në përpjesëtim të drejtë dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën kontratës që do të prokurohet. Këto kërkesa janë hartuar teje të fryra, disa prej tyre janë kufizuese dhe penguese dhe nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, shmangin konkurrencën, nuk sigurojnë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues ndërmjet operatorëve ekonomik. Këto shkelje janë bërë shkaqet apo arsyet kryesore të cilat KVO i ka shfrytëzuar duke bërë vlerësime subjektive dhe të njëanshme dhe ka s`kualifikuar padrejtësisht disa operatori ekonomik që kanë pasur ofertat ekonomike më të ulët se operatorët fitues. Këto shkelje kanë pasur impakt negativ në buxhetin e Bashkisë Korçë me rritje fiktive të fondeve në vlerën totale **58,946,000 lekë** .

Rekomandim: Bashkia Korçë të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësinë për mos përdorim me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve publike **në vlerën totale 58,946,000 lekë**.

5. Gjetje: Në objektin “Rikonstruksioni i parkut Rinia” Korçë, nga auditimi i dokumentacionit teknik mbi hartimin e projekt të zbatimit dhe preventivit të punimeve të ndërtimit, të administruara në dosjen teknike rezulton se, janë preventivuar tepër fond limit, si pasojë e rritjes fiktive të çmimeve të krahasuar me manualin teknik të çmimeve dhe rritjes fiktive të volumeve të punimeve në krahasuar me projektin e zbatimit të miratuar, në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë fushën e kontrollit dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, fushën menaxhimit financiar dhe kontrollit, dhe fushën e prokurimit publik, duke i sjell buxhetit të Bashkisë rritje fiktive të fondeve në vlerën 2,055,572 lekë .

Rekomandim: Bashkia Korçë, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve publike **në vlerën 2,055,572 lekë.**

6. Gjetje: Në objektin “Rikonstruksioni i parkut Rinia” Korçë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit si dhe nga verifikimi në terren, deri në momentin e auditimit rezultuan, diferenca në volume pune të pakryera dhe të likuiduara, në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë fushën kontrollit dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, duke i sjell buxhetit të Bashkisë rritje fiktive të fondeve në vlerën 9,025,227 lekë .

Rekomandim: Bashkia Korçë, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve publike **në vlerën 9,025,227 lekë.**

7. Gjetje: Në objektin “Sheshi dhe Rrugicat tek kulla Panorama, Sheshi tek Teatri” Korçë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit si dhe nga verifikimi në terren, deri në momentin e auditimit rezultuan, diferenca në volume pune të pakryera dhe të likuiduara, në kundërshtim me, aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë fushën kontrollit dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, duke i sjell buxhetit të Bashkisë rritje fiktive të fondeve në vlerën 5,217,780 lekë .

Rekomandim: Bashkia Korçë, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve publike **në vlerën 5,217,780 lekë.**

8. Gjetje: Në objektin “Projekti Shkolla qendër komunitare: Terrene sportive në katër shkolla të qytetit Korçë (shkolla Demokracia, shkolla Naum Veqilharxhi, shkolla Sotir Gura, dhe kompleksi shkollor Ajet Xhindolli)” Korçë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit si dhe nga verifikimi në terren rezultuan, diferenca në volume pune të pakryera dhe të likuiduara, në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë fushën kontrollit dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, duke i sjell buxhetit të Bashkisë rritje fiktive të fondeve në vlerën 1,132,230 lekë.

Rekomandim: Bashkia Korçë, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve publike **në vlerën 1,132,230 lekë.**

9. Gjetje: Në objektin “Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në qytet (përmirësimi i ndriçimit, vendosje tabela sinjalistike për rrugët me një kalim dhe sistemim asfaltim)” Korçë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan, diferenca në volume pune të pakryera dhe të likuiduara, në kundërshtim me, aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë fushën kontrollit dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, duke i sjell buxhetit të Bashkisë, rritje fiktive të fondeve në vlerën 65,000 lekë .

Rekomandim: Bashkia Korçë, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve publike **në vlerën 65,000 lekë.**

10. Gjetje: Në objektin “Restaurimi i Pazarit të Vjetër te Korçës”, nga auditimi i dokumentacionit teknik mbi hartimin e projekt të zbatimit dhe preventivit të punimeve të ndërtimit, rezulton se, janë preventivuar tepër fond limit, si pasojë e rritjes fiktive të çmimeve të krahasuar me manualin teknik të çmimeve si dhe rritjes fiktive të

volumeve të punimeve krahasuar me projektin e zbatimit, në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë fushën e kontrollit dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, fushën menaxhimit financiar dhe kontrollit, dhe fushën e konkurrimit publik për punimet e restaurimit, duke i sjell buxhetit të Bashkisë rritje fiktive të fondeve në vlerën 1,738,490 lekë .

10.1.Rekomandim: Bashkia Korçë, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve publike **në vlerën 1,738,490 lekë.**

11. Gjetje: Në objektin “Restaurimi i Pazarit të Vjetër të Korçës”, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit si dhe nga verifikimi në terren, deri në momentin e auditimit rezultuan, diferenca në volume pune të pakryera dhe të likuiduara, në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë, fushën e punimeve të restaurimit dhe fushën kontrollin dhe disiplinimin të punimeve të ndërtimit, duke i sjell buxhetit të Bashkisë, rritje fiktive të fondeve vlerën **12,069,637 lekë.**

Rekomandim: Bashkia Korçë, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve publike **në vlerën 12,069,637 lekë.**

12. Gjetje: Në objektin “Rikonstruksioni i Rrugës “Gjon Buzuku”, sheshi i Poliklinikës, sheshi i Xhamisë, sheshi i Pazarit, rruga e “Mborjes”, rruga e “Rahovikut”, Korçë, nga auditimi i dokumentacionit teknik mbi hartimin e projektit të zbatimit dhe preventivit të punimeve të ndërtimit, të administruara në dosjen teknike rezulton se janë preventivuar tepër fond limit, si pasojë e rritjes fiktive të çmimeve krahasuar me manualin teknik të çmimeve dhe rritjes fiktive të volumeve të punimeve të krahasuar me projektin e miratuar të zbatimit, në kundërshtim me, aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë fushën e kontrollit dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, fushën menaxhimit financiar dhe kontrollit, dhe fushën e prokurimit publik, duke i sjell buxhetit të Bashkisë rritje fiktive të fondeve në vlerën 1,429,279 lekë .

Rekomandim: Bashkia Korçë, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve publike **në vlerën 1,429,279 lekë.**

13. Gjetje: Në objektin “Rikonstruksioni i Rrugës “Gjon Buzuku”, sheshi i Poliklinikës, sheshi i Xhamisë, sheshi i Pazarit, rruga e “Mborjes”, rruga e “Rahovikut” Korçë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit si dhe nga verifikimi në terren, deri në momentin e auditimit rezultuan, diferenca në volume pune të pakryera dhe të likuiduara në kundërshtim me, ligjin nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, dhe aktet nënligjore që rregullojnë fushën kontrollit dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, duke i sjell buxhetit të Bashkisë rritje fiktive të fondeve në vlerën 2,957,800 lekë.

Rekomandim: Bashkia Korçë, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve publike **në vlerën 2,957,800 lekë.**

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 58 “Llojet e masave disiplinore” dhe nenin 59 “Kompetencat dhe procedurat për masat disiplinore” të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për

nëpunësin civil” dhe VKM nr. 171, datë 26.3.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Korçë:

Të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësisë, shkallën e përgjegjësisë për mangësitë dhe shkeljet për secilin punonjës, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe të filloi procedurat për dhënien e masave disiplinore:

I. Nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”, për:

1. Znj. B.Th, Zëvendëskryetare e Bashkia, Korçë:

Kjo punonjëse me cilësinë e Kryetarit të Njesisë së Vlerësimit të Ofertave, në procedurën e konkurrimit publik për “Restaurimi i pazarit të vjetër të Korçës, me vlerë kontrate të përlllogaritur 260,120,439 lekë, të realizuar në vitin 2014, ka vepruar në kundërshtim, me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën e konkurrimit publik për restaurimet e monumenteve të kulturës. Po kështu, me cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në procedurat e prokurimit: “Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare “Mësonjëtorja e parë” me fond limit 48,430, 009 lekë të realizuar në vitin 2014, “Rikonstruksion i shkalleve dhe varrezave të dëshmoreve” me fond limit 19,410,096 lekë, të realizuar në vitin 2014, “Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Stavri Themeli” me fond limit 41,666,221 lekë të realizuar në vitin 2015, “Rikonstruksion i rrugës Gjon Buzuku” me fond limit 241,990,774 lekë të realizuar në vitin 2015 dhe “Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në qytet” me fond limit 41,642,0154 lekë, të realizuar në vitin 2015, ka vepruar në kundërshtim, me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën e Prokurimit Publik.

2. Znj. D.T, Përgjegjëse e Sektorit të Buxhetit:

Kjo punonjëse me cilësinë e anëtarit të Njesisë së Vlerësimit të Ofertave, në procedurën e konkurrimit publik për “Restaurimi i pazarit të vjetër të Korçës, me vlerë kontrate të përlllogaritur 260,120,439 lekë të realizuar në vitin 2014, ka vepruar në kundërshtim, me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën e konkurrimit publik për restaurimet e monumenteve të kulturës. Po kështu, me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në procedurën e prokurimit: “Rikonstruksion i shkalleve dhe varrezave të dëshmoreve” me fond limit 19,410,096 lekë të realizuar në vitin 2014, ka vepruar në kundërshtim, me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën e Prokurimit Publik.

3. Znj. M.S, Përgjegjëse e Sektorit të Prokurimeve:

4. Z. B.M, Specialistë në Drejtorinë e PKZHT:

5. Z.L.Gj, Dretor i Drejtorisë së Menaxhimit të Kontratave:

Këta punonjës me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në procedurat e prokurimit: “Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare “Mësonjëtorja e parë” me fond limit 48,430, 009 lekë të realizuar në vitin 2014, “Rikonstruksion i shkalleve dhe varrezave të dëshmoreve” me fond limit 19,410,096 lekë të realizuar në vitin 2014, “Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “Stavri Themeli” me fond limit 41,666,221 lekë të realizuar në vitin 2015, “Rikonstruksion i rrugës Gjon Buzuku” me fond limit 241,990,774 lekë të realizuar në vitin 2015 dhe “Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në qytet” me fond limit 41,642,0154 lekë, të realizuar në vitin 2015 ka vepruar në kundërshtim, me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën e Prokurimit Publik. Po kështu, ka vepruar në kundërshtim me kushtet e kontratave të zbatimit për 4 objekte: “Sheshi dhe rrugicat tek kulla Panorama, sheshi tek teatri”, “Qendra për

mbrojtjen dhe promovimin e kulturës”, “Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në qytet” dhe “Rikonstruksion i Parkut Rinia” duke mos llogaritur penalitetin për vonesat e përfundimit të punimeve të cilat në total shkojnë në vlerën totale 76,870,080 lekë. Gjithashtu, ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, pasi nuk ka zbatuar kontratën lidhur midis Bashkisë Korçë dhe subjektit sipërmarrës “Ortakëria Korça” për subvencionimin e vlerës së biletës së udhëtimit urban për moshat e treta, duke shkaktuar efekt negativ financiar për Bashkinë në vlerën 8,482,570 lekë.

6. Z. K.K, Përgjegjës Sektori i Ligjishmërisë:

Ky punonjës me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në procedurat e prokurimit: “Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare “Mësonjëtorja e pare” me fond limit 48,430, 009 lekë të realizuar në vitin 2014, “Rikonstruksion i shkalleve dhe varrezave të dëshmorëve” me fond limit 19,410,096 lekë të realizuar në vitin 2014 dhe “Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Stavri Themeli” me fond limit 41,666,221 lekë të realizuar në vitin 2015, ka vepruar në kundërshtim, me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën e Prokurimit Publik.

7. Z. O.L, Specialist në Drejtorinë e PKZHT:

Ky punonjës me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në procedurën e prokurimit: “Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare “Mësonjëtorja e pare” me fond limit 48,430, 009 lekë të realizuar në vitin 2014, ka vepruar në kundërshtim, me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën e Prokurimit Publik.

8. Znj. M.L, Përgjegjëse e Sektorit të Kontabiliteti:

Kjo punonjëse me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në procedurat e prokurimit: “Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare “Mësonjëtorja e pare” me fond limit 48,430, 009 lekë të realizuar në vitin 2014, “Rikonstruksion i rrugës Gjon Buzuku” me fond limit 241,990,774 lekë të realizuar në vitin 2015 dhe “Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në qytet” me fond limit 41,642,0154 lekë, të realizuar në vitin 2015, ka vepruar në kundërshtim, me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën e Prokurimit Publik.

9. Z. N.S, Specialist në Drejtorinë e PKZHT:

Ky punonjës me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në procedurat e prokurimit: “Rikonstruksion i shkalleve dhe varrezave të dëshmorëve” me fond limit 19,410,096 lekë të realizuar në vitin 2014, “Rikonstruksion i rrugës Gjon Buzuku” me fond limit 241,990,774 lekë të realizuar në vitin 2015 dhe “Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në qytet” me fond limit 41,642,0154 lekë, të realizuar në vitin 2015 ka vepruar në kundërshtim, me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën e Prokurimit Publik.

10. Z. O.P, specialist në Drejtorinë e Financës:

11. Z. H.N, specialist në Drejtorinë e PKZHT:

Këta punonjës me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në procedurën e prokurimit: “Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Stavri Themeli” me fond limit 41,666,221 lekë të realizuar në vitin 2015, ka vepruar në kundërshtim, me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën e Prokurimit Publik.

12. Znj.A.D, Drejtore e Drejtorisë Juridike:

Kjo punonjëse me cilësinë e Anëtares së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në procedurat e prokurimit: “Rikonstruksion i rrugës Gjon Buzuku” me fond limit 241,990,774 lekë të realizuar në vitin 2015 dhe “Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në qytet” me fond limit 41,642,0154 lekë, të realizuar në vitin 2015 ka vepruar në

kundërshtim, me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën e Prokurimit Publik. Po kështu, ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 335, datë 02.6.1998 “Për procedurat për zbatimin e vendimeve Gjyqësorit për detyrimet që prekin buxhetin e shtetit”, pasi në 2 raste, ka lejuar të paguhen shpenzime në shumën 1,243,006 lekë në bazë të Vendimeve të Gjykatës së Shkallës së parë, pa bërë më parë rekurs në Gjykatat e tjera.

13. Z. I.L, Kryeinspektor i IMT-së:

Ky punonjës, ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 10119 datë 23.04.2009 për “Planifikimin e Territorit”, me ligjin nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektoratin e ndërtimit” dhe me VKM-në nr. 862, datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga INUK dhe INUV”, sepse për 13 vendime të marra për pezullimin e ndërtimeve dhe në 13 vendime të tjera të marra për prishje ndërtimesh, ndërtime këto të cilat kanë qenë në papajtueshmëri me legjislacionin në fuqi, nuk ka marrë asnjë masë dënimi me gjobë, duke krijuar të ardhura të munguara në shumën 4,200,000 lekë

14. Z. V.P, Specialiste në Drejtorinë e Menaxhimit të Kontratave:

Kjo punonjëse, ka vepruar në kundërshtim me Vendimin Nr.514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit” i ndryshuar me VLM nr. 664, datë 26.09.2012, sepse ka rritur fiktivisht në vlerën 8,087,772 lekë, fondin limit të punimeve elektrike të objektit “Rikonstruksioni i parkut Rinia”.

D. MASA ADMINISTRATIVE

Në mbështetje të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, Kreu III-të “Sanksionet” nenet 15 e 16, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Korçë, t’i kërkoj Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes dhe Kontrollit të Territorit në Bashkinë Korçë, të vendosë gjobë, për:

1. Z. E.N, me cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve të ndërtimit.

2. Z. A.A, me cilësinë e kolaudatorit të punimeve.

Sepse gjatë zbatimit të punimeve të objektit “Projektin Shkolla qendër komunitare: Terrene sportive në katër shkolla të qytetit Korçë (shkolla Demokracia, shkolla Naum Veqilharxhi, shkolla Sotir Gura, dhe kompleksi shkollor Ajë Xhindolli)” ka vepruar në kundërshtim me kontratën e lidhur me Bashkinë Korçë për kolaudimin e punimeve dhe me nenin 12 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, për pasojë i është shkaktuar bashkisë Korçë dëm ekonomik në vlerën totale 1,132,230 lekë.

3. Z.E.T, me cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve të ndërtimit.

Sepse gjatë zbatimit të punimeve të objektit “Rikonstruksioni i Rugës “Gjon Buzuku”, sheshi i Poliklinikës, sheshi i Xhamisë, sheshi i Pazarit, rruga e “Mborjes”, rruga e “Rahovikut” Korçë, ka vepruar në kundërshtim me kontratën për mbikëqyrjen e punimeve të lidhur me Bashkinë Korçë dhe me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, për pasojë i është shkaktuar bashkisë Korçë dëm ekonomik në vlerën totale 2,957,800 lekë.

4. Z. L.H, me cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve të ndërtimit.

Sepse gjatë zbatimit të punimeve të objekteve “Rikonstruksioni i parkut Rinia” “Zbatimi i Punimeve Sheshi dhe Rugicat tek kulla Panorama, Sheshi tek Teatri” dhe “Restaurimi i Pazarit të Vjetër të Korçës” ka vepruar në kundërshtim me kontratat e

lidhur me Bashkinë Korçë për mbikëqyrjen e punimeve, dhe me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, për pasojë i është shkaktuar Bashkisë Korçë, dëm ekonomik në vlerën totale 27,282,964 lekë. Po kështu, gjatë zbatimit të punimeve për objektet “Rikonstruksioni i parkut Rinia” dhe “Zbatimi i Punimeve Sheshi dhe Rrugicat tek kulla Panorama, Sheshi tek Teatri” ka situacionuar punime në vlerën 24,710,922 lekë të pa kryera në fakt, të cilat më pas janë likuiduar në formë paradhënie.

E. VLERËSIMI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE

KLSH do të ndjek me vëmendje të veçantë dhe vlerësojë dhe marrjen e masave, që do të marrë Bashkia Korçë për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga auditimi i kryer, reflektimin e tyre në përmirësimin e proceseve të veprimtarisë ekonomiko-financiare, me qëllim mirë përdorimin e fondeve publike, në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit në shërbim të komunitetit.

Në përfundim të afateve të përcaktuara në rekomandimet e dëguara dhe afatin e caktuar 6 muaj, në nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, do të kryejmë auditim të veçantë, përcurorinë dhe nivelin e zbatimit të masave të rekomanduara.

Nga Bashkia Korçë, nuk është kthyer përgjigje akoma, së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, pasi nuk është ezauruar afati ligjor prej 20 ditë, **pra rezulton se rekomandimet janë në proces vlerësimi.**

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Bashkim Arizaj, Julian Adili, Perparim Gjuzi, Josif Lile, Taulant Dervishaj dhe Jonild Hoxhaj,, më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT